



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SH.A UJËSJELLËS – KANALIZIME FIER

Nr. _____ prot

Fier, më ____ . ____ 2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Perditesim i Programit te Faturimit, Migrim i te dhenave dhe web-service per pagesat e faturat e ujit te pijshem”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbimet e lidhura me Soft Waret 72260000-5

VLERA E FONDIT LIMIT:

9.500.000 (nente milion e peseqind mije) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Sh.a.Ujesjelles-Kanalizime” Fier, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.1.2 Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

➤ **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare(2019-2020-2021), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 40% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në **nenin 77 pika 3 i LPP**, si dhe **nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021** “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilanceve për vitet (2020-2021) të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2021**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.2.4 Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 ”Për Prokurimin Publik”,

Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës. **Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është: 190.000 (njqind e nentedhjetë mijë) leke pa TVSH**

Kapaciteti ekonomik i sh.a. Ujesjelles-Kanalizime Fier eshte i qendrueshem dhe e perballon fondin limit per kete prokurim dhe kontraten qe do te lidhet pas perfundimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik konkurues duhet të jetë i certifikuar me:

ISO 27001 ose ekuivalente (për Sigurinë e Informacionit) e përditësuar

ISO 9001 ose ekuivalente (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) e përditësuar

BS PASS 99:2012 ose ekuivalente (Menaxhimi i sistemeve të integruar) e përditësuar

Argumentim: Nisur nga proceset e punës kritike, rëndësisë së shërbimeve që sistemi ofron, gjykohet e arsyeshme që operatorët ekonomik, proceset e punës së tyre, ti bazojnë ne standartet botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara që garantojnë ISO për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë dhe për Sigurinë e Informacionit.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatorët të zotërojnë aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë, kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

Sistemi i Menaxhimit të Integruar është i domosdoshëm të zbatohet nga OE në rastet kur ka integrim të dy ose më shumë sistemeve sic është në rastin konkret.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 5 punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj)

Plotësimi i këtij kriteri duhet të vërtetohet me paraqitjen e formularëve E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit, duke ju referuar datës së hapjes së ofertave dhe diplomave të shkollimit të lartë universitar për secilin prej punonjësve.

2.3.3 Këta punonjës duhet të jenë të certifikuar si vijon:

Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2(dy) punonjës të certifikuar si “Ekspertë të Certifikuar” në zhvillim dhe implementimin e zgjidhjes së ofruar. Kjo të vërtetohet përmes paraqitjes së Certifikatës së lëshuar nga një Kompani e licensuar nga autoritetet përkatëse shtetërore. Kjo kompani të jetë vet Prodhues i sistemit ose i autorizuar nga Prodhuesi i licensuar për të lëshuar atë lloj certifikate.

Argumentim: Për të siguruar aftësinë në implementimin e kërkesave për ndryshim, zgjidhja e incidenteve dhe problemeve, zgjerim i funksionaliteteve etj., kërkohet që OE të ketë në stafin e propozuar të paktën 2(dy) persona me njohuri/aftësi të nevojshme të certifikuar nga prodhuesi i teknologjive bazë të sistemit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1(një) specialist të certifikuar në konceptet e inxhinierizimit të ëeb shërbimeve dhe protokollit SOAP. Këto certifikata garantojnë që programuesit janë të aftësuar me zhvillim e sistemeve arkitekturore e prirur drejt shërbimeve në rrjet/sistemeve të shpërndara.

Argumentim: Nevojitet për të garantuar integrimin e sistemeve të brendshme dhe me sistemet e palëve të treta.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1(një) specialist të certifikuar në programim në Web.

Argumentim: Meqënëse sistemi kërkohet të jetë i bazuar në teknologji në ëeb, atëherë kërkohet që të ketë specialistë të cilët e njohin këtë teknologji.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1(një) specialist të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL) ose ekuivalente.

Argumentim: Meqënëse kontrata do të ketë mirëmbajtje atëherë duhet një ekspert për të garantuar respektimin e SLA.

2.3.7 Sistemi duhet të jetë OTS (off-the-shelf). Ky system duhet të ketë kosto licencash për instalime në ambjent test, ambjent zhvillimi dhe për shtimin e përdoruesve.

Për të vërtetuar këto kushte ofertuesit duhet të paraqesin:

1. Autorizim Prodhuesi për implementim, mirëmbajtje dhe zhvillim i cili të specifikojë projektin, datën, adresën e qartë të prodhuesit dhe të bashkëngjisë Çertifikatën e regjistrimit të sistemit.
2. Deklaratë nga Prodhuesi i Sistemit ku të përcaktohet qartë mënyra e licensimit të sistemit që kërkohet të implementohet.
3. Deklaratë nga Prodhuesi që sistemi I modulit është integruar me modulet e tjera sic kërkohet në specifikimet teknike, duke i përmendur saktë emrat e sistemeve apo moduleve me të cilat është integruar dhe duke përcaktuar qartë mënyrën dhe informacionin që është integruar.

Argumentim: Që të sigurohet aftësia për implementimin e sistemit dhe bazuar në proceset e punës kritike dhe rëndësisë së shërbimeve që sistemi ofron, kërkohet që OE të ofrojë një sistem i cili është i gatshëm dhe vetëm do të implementohet.

Sistemi nuk duhet të ketë kosto licensash për krijim të ambjentit test, ambjentit të zhvillimit dhe për shtimin e përdoruesve në përgjithësi në të gjithë ambjentet.

Për të vërtetuar këtë kusht ofertuesit duhet të paraqesin:

2.3.8 Deklaratë nga Prodhuesi i Sistemit ku përcaktohet qartë mënyra e licensimit të sistemit që kërkohet të implementohet.

- a. Licensat e shfrytëzimit për të gjithë përbërësit e sistemit të ofruar të përkthyer dhe ekuivalentuar në gjuhën shqipe.

Argumentim: Duke qenë se autoriteti mund të kërkojë instalimin e disa versioneve për qëllime testimi, zhvillimi etj..por jo për përdorim “production” , atëherë nuk ka pse të ketë pengesë licensash për këto instalime apo për prova paraprake që autoriteti do të ketë dëshirë të kryejë në sistem.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/Distributori ku të autorizohet operatori për shitjen e produkteve harëare dhe softëare të përfshira në këtë ëobjekt prokurimi për territorin e Shqipërisë.

Në rast të paraqitjes së Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit.

Dokumentacioni të jetë në gjuhën shqipe dhe të ketë të gjithë kontaktet (nr.telefoni, e-mail) si edhe adresën eëb të Prodhuesit apo Distributorit për konfirmim të dokumentave të paraqitura.

Në dokumentin e autorizimit të jenë të përcaktuara emri i Autoritetit Kontraktor, titulli dhe numri i referencës së kësaj procedure. Të jetë e përcaktuar emri, nipti dhe adresa fizike e operatorit ekonomik. Autorizimi le të ketë edhe datën e lëshimit përpara datës së zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Ky kriter plotësohet me doëzimin e formularit përmbledhës të veëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

2.4 Për cdo produkt të ofertuar OE duhet të dorëzojë Part Number/Model përkatës në mënyrë që të bëhet më i lehtë verifikimi.

Argumentim: AK kërkon që të dorëzohet part number për të verifikuar specifikimet teknike të produkteve.

TERMAT REFERENCES

OBJEKTIVAT, QELLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Pergjithshem

- Zhvillimi i Sistemit te Faturimit, per perpunimin te te dhenave te abonenteve dhe administrimit te tyre
- Zhvillimi i Sistemit te Leximit, dhe integrimin me Sistemin e Faturimit.
Aplikacion per pajisjet e leximit
- Implementimi i sherbimeve te pagesave nepermjet perdorimit te Web Service dhe ofrimin e tyre per te gjithe kanalet e pagesave

2.2. Qellimi

Vazhdimesia e punes per menaxhimin e abonenteve, faturimit, pagesave dhe realizimin e leximeve nepermjet Palmareve (pajisjeve mobile) nga operatoret, transferim i te dhenave dhe permiresimi i procesit te administrimit dhe kontrollit te te dhenave.

2.3. Rezultatet qe duhet te arrihen nga Kontraktori

- Sistemimi dhe transferimi i te dhenave te Ujesjellesit te Fier
- Sistemimi dhe transferimi i te dhenave te Ujesjellesit te Mallakaster
- Sistemimi dhe transferimi i te dhenave te Ujesjellesit te Patos
- Sistemimi dhe transferimi i te dhenave te Ujesjellesit te Roskovec
- Versionimi dhe aplikimi i modifikimeve te lidhura me zhvillimet
- Zhvillim dhe implementim I sistemit te leximit te matesave
- Trajnimin e stafit per perdorimin e sistemit

2. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

Realizimi i ketij projekti behet nen supozimin qe do te kete nje perfshirje total te aktoreve kyç si ne zhvillimin dhe implementimin e sistemit te Faturimit dhe te Leximit, azhornimin dhe transferimin e te dhenave, apo implementimin e sherbimit te pagesave dhe trajnimit te perdorueseve.

Perfshirja e plote e aktoreve kyç eshte thelbesore per mbarevajtjen me sukses te projektit.

3.2. Risqet

Seksioni III: Termat dhe kushtet e kontratës

Mos perfshirja e te gjithe aktoreve kyç do te sjelle mangesi ne zhvillim, implementim dhe funksionalite te kerkuara si dhe ne saktesine e te dhenave.

3. QELLIMI I PUNES

4.1. Te pergjithshme

Institucioni administrues prane te cilit do te realizohet implementimi lidhur me Sistemin e Faturimit, Transferimet, Pagesat Online dhe Sistemin e Leximeve per Leximet me pajisje mobile dhe trajnimi i perdorueseve, do te jete Ujesjelles Kanalizime Fier Sh.a.

4.1.1. Pershkrimi i detyres

Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Fier Sha kerkon qe te realizohet:

- Ngritjen e Sistemit te Faturimit
- Ngritjen e Sistemit te Leximi
- Blerja e pajisjeve te leximit
- Integrimi I sistemeve te Faturimit dhe Leximit
- Transferim i te dhenave te Abonenteve te Ujesjellesit te Fier ne sistemin e ri.
- Transferim i te dhenave te Abonenteve te Ujesjellesit te Mallakaster ne sistemin e ri.
- Transferim i te dhenave te Abonenteve te Ujesjellesit te Patos ne sistemin e ri.
- Transferim i te dhenave te Abonenteve te Ujesjellesit te Roskovec ne sistemin e ri.
- Kontrolle shtese per emrat e abonenteve, te dhenave ndihmese si NID apo perdoruesin, faturimeve dhe pagesave.
- Zhvillimi dhe pershtatja e formave te administrimit te abonentit per marrjen e te dhenave te detyrueshme si NID, NIPT, etj.
- Zhvillimi dhe pershtatja e formes se konsultimit per shfaqjen e te gjitha te dhenave te mundshme referuar te dhenave te ujesjellesave te tjere (kontrollin e fatures se fiskalizuar, fatures se printuar me te gjitha elementet, fotot e matesave, etj.)
- Krijim dhe ndarje te raporteve per faturimin, arketimin dhe debine sipas Bashkive dhe Njesive Administrative
- Sistemim te Data Bazes per te perballuar numrin e shtuar te klienteve dhe te dhenave
- Saktesimi dhe draftimi i procedures se backup dhe perfshirja e te gjitha skemave ne kete procedure
- Krijimi i nje strukture programi dhe database test per te gjitha zhvillimet
- Shtimi i Sigurise se aksesimit te sistemit nga lexuesit, mbrojta e sistemit nga sulmet kibernetike
- Qendrueshmeria dhe Zgjerueshmeria e Sistemit
- Versionimi dhe aplikimi i modifikimeve te lidhura me zhvillimet
- Ruajtja e historikut te ndryshimeve te leximeve, faturimeve dhe arketimeve
- Trajnimin e stafit

4.1.2. Hapesira gjeografike

Sistemi i Faturimit, pershtatja dhe transferimi i te dhenave, si dhe sherbimet e pagesave nepermjet web service do te kryhen dhe implementohet ne zyrat kryesore te Ujesjelles Kanalizime Fier Sha.

4.1.3. Siguria e Sistemit

Kerkesat per sigurine e sistemit jane te percaktuara qartesisht ne seksionet e kerkesave funksionale dhe atyre teknike, si persa i perket sigurise dhe roleve te perdorueseve (moduli i hyrjes ne sistem dhe moduli i roleve dhe perdorueseve) ashtu edhe sigurine e infrastruktures, backup, etj.

Çdo perdorues do te njihet nga sistemi ne menyre qe ai te kete te drejte te hyje ne te me ane te identifikimit me perdorues unik dhe fjalekalimin e tij personal. Vetem pas identifikimit te tij me te drejta plotesisht te percaktuar, ai mund te vijoje me punen.

Te gjitha te dhenat e ruajtura ne aplikacion, perfshire edhe ato te konfigurimeve si dhe te perdorueseve te sistemit duhet te ruhen ne nje baze te dhenash RDBMS e cila ploteson kerkesat ne lidhje me integritetin e te dhenave dhe sigurise.

Sistemi duhet te suportojte mjete eficiente auditimi, aktivizimin e ruajtjes se historikut dhe te ndryshimeve, percaktimin e historikut te te gjitha veprimeve te te shkuares dhe te ardhmes (modifikim, shtim, fshirje). Ruajtja te realizohet per te dhena specifike ne tabela dhe forma te cilat mund te zgjidhen nga administratoret e sistemit.

Moduli i Faturimit dhe Pagesave

Moduli i Faturimit dhe Pagesave duhet të ofrojë funksionalitetet e mëposhtme:

- Modul per krijimin e artikujve dhe planeve tarifore
- Modul për rregjistrin e abonentëve dhe profilin e abonentit
- Modul per regjistrimin e matesave
- Modul per hedhjen e leximeve
- Modul per faturimin e abonentëve
- Modul per arketimin e faturave te abonenteve
- Raporte
- Integrim me sistemet e pagesave qe vijne nga palet e treta
- Integrim me Sistemin e Leximit Automatik te matesave

Moduli per krijimin e artikujve dhe planeve tarifore

Artikujt përfshijnë shërbimet që sistemi u ofron abonentëve ose produktet fizike që përdoren nga UK, për qëllime të ndryshme. Plani tarifor përshkruan mënyrën se si do të tarifohen klientët që i përkasin një kategorie të caktuar. Kjo ndarje duhet bërë pasi një konsumator në kategorinë “Familje” mund t’i ofrohen artikuj të ndryshëm me një klient në kategorinë “Institucion”.

Seksioni III: Termat dhe kushtet e kontratës

Një plan tarifor diferencohet nga artikujt që do të përfshijë, pra janë pikërisht artikujt dhe të dhënat për çmimet, sasinë, frekuencën e tarifimit, që përcaktojnë një plan tarifor.

Sistemi duhet të mundësojë krijimin e planeve tarifore nga nderfaqja në mënyrë të lehtë për përdoruesit. Për planet e tarifimit duhet të jetë mundësia e përcaktimit të frekuencës së tarifimit.

Modul për regjistrin e abonentëve dhe profilin e abonentit

Moduli i Faturimit dhe Arketimit duhet të përfshijë funksionet për krijimin dhe

rregjistrimin e abonentëve. Për çdo abonent ekzistues ose të ri sistemi duhet të përmbajë

minimalisht këto fusha:

- Emri i klientit
- Nr. Dokumentit – bëhet fjalë për numrin e ID-së së klientit.
- Datë/Nr. kontrate
- Nr. Familjarëve – përkon me numrin e pjestarëve në rastin e një familjeje.
- Kategoria e Konsumatorit,
- Adresa
- Vendodhja në hartë
- Plani tarifor
- NIPT – në rastin e bizneseve ose institucione publike
- Te dhënat e matësimit të klientit
- Statuset e klientit - aktiv, pasiv, prerje, njoftim debitori etj.

Modul për regjistrimin e matësive

Matësit përfaqësojnë pajisjet teknike që vendosen në ambientet e konsumatorëve dhe bëjnë matjen e sasisë së konsumuar të një artikulli, dhe në rastin aktual të ujit të pijshëm. Një matës mund të krijohet gjatë çeljes së një klienti të ri ose mund të krijohet dhe një mënyrë të pavarur, dhe të caktohet më pas një klienti.

Informacioni që duhet të plotësohet për matësin e ri duhet të përmbajë:

Numri i matësit - numër unik për identifikimin dhe referimin e matësit në sistem.

Fillimi i numërimit- përcakton vlerën fillestare të matësit në momentin që do të vendoset te një klient.

Tipi i matësit,

Data e plumbosjes dhe Data e prodhimit i referohet datës kur është prodhuar dhe plumbosur aparati matës.

Lloji i matësit

Diametri

Ne cdo moment UK duhet te kete mundesi te shikoje raporte mbi matesat e regjistruar, matesat e instaluar, nderrimet e matesave etj

Modul per hedhjen e leximeve

Ne kete modul duhet te menaxhohet printimi I listave per leximin e abonenteve, hedhja e leximeve nga operatoret, kryerja e kontrolleve perpara se te behet mbyllja e periudhes se faturimit.

Modul per faturimin e abonentëve

Ne modulën e faturave duhet te jepet informacion per periudhat e faturimit. Periudha e faturimit përfshin një periudhë kohore të caktuar, zakonisht një mujore, brenda të cilës do të agregohen të dhënat mbi konsumin e artikujve të ndryshëm nga klientët brenda kësaj periudhe, me rezultat final gjenerimin e faturave për ta. Ketu duhet te jepet informacion per numrin e abonenteve te faturuar vleren e faturimit etj.

Modul per arketimin e faturave te abonenteve

Moduli I arkes është një nga pikat kryesore të sistemit të faturimit. Në këtë modul duhet te menaxhohen të gjitha arketimet e realizuara nga abonentët nepermjet arkave, bankave ose paleve te treta te tjera, krijimi i mandative te arkëtimi, krijimi I njesive te reja te arkave ose bankave etj.

Per cdo veprim arke duhet te ruhet operatori I cili realizon arketimin, data dhe ora e sakte e veprimit.

Sistemi duhet te mundesoje regjistrimin e likuidimit te plote edhe te pjesshem te faturave.

Raportet

- Sistemi duhet te jete i pajisur me raporte te shumta te cilat japin informacion mbi:
- Faturimin sipas zonave
- Faturimin sipas klasave te sherbimit
- Faturimin sipas kategorive te klienteve
- Mbi debine e detajuar te abonenteve
- Debine sipas Kategorise se kliente
- Debine sipas klasave te sherbimit
- Raporte mbi konsumin
- Raporte krahasuese mbi faturimin ne periudha te ndryshme kohore
- Raporte per matest e vendosur ne periudhe kohore
- Raporte te detajuara per arketimin
- Etj
- Raportet duhet te eksportohen ne pdf dhe ne excel.

Moduli i manaxhimit te perdoruesve

Sistemi duhet te kete modul te qenderzuar per manaxhimin e perdoruesve ne sistem duke mundesuar manaxhimin e roleve, te drejtave te te tyre ne sistem, perdoruesve, percaktimin e tyre neper role, etj.

Sistemi te ofroje funksionalitet per te percaktuar zonat IP nga ku mund ta aksesojne sistemin perdorues te caktuar.

Moduli i konfigurimeve

Seksioni III: Termat dhe kushtet e kontratës

Sistemi duhet te kete nje modul te qenderzuar ku te jete mundesia te konfigurohen parametrat per te gjithë modulet duke perfshire faturimin e arketimet, kontabilitetin, sigurine e sistemit, te dhena per ndermarrjen, etj.

Te jete mundesia qe te konfigurohet politika e fortesise, gjatesise, skadences e password ne sistem.

Integrimi dhe Migrimi

Sistemi te perbehet nga module te cilat jane te integruara mes tyre qe ndajne te njejtin modul te drejta perdoruesish dhe sigurie, modul raportimi, modul konfigurimi parametrash, etj. Sistemi duhet te integrohet me kanalet e pagesave elektronike te cilet jane sisteme informatike te paleve te treta qe komunikojne nepermjet web sherbimeve te vecanta per secilen pale. Modulet duhet te jene te integruar mes tyre. Moduli I faturimit duhet te jete I integruar me modulim e leximit te matesave duke pranuar leximet e kryera nga lexuesit dhe kalimin automatik te tyre ne sistemin e faturimit. Gjithashtu ofruesi I sherbimit duhet te marre persiper qe te migroje te dhenat nga nderfaqet e sistemit aktual brenda afatit te implementimit.

Afati i implementimit

Sistemi i perbere nga moduli i Faturimit dhe Arketimit, duhet te implementohen ne cloud.

Implementimi I software dhe migrimi I te dhenave nga nderfaqet e sistemit aktual duhet te perfundoje brenda 2 muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Trajnimi dhe manualet

Sistemet duhet te shoqerohen me manualet perkatese ne gjuhen shqipe. Ofruesi i sherbimit duhet te realizoje trajnimin e perdoruesve ne zyrat e UK ose online.

Kerkesa te pergjithshme

- Sistemi duhet te implementohet ne cloud.
- Sistemi duhet të ofrohet tërësisht web based, pra cdo përdorues duhet të ketë mundësinë ta përdorë atë nga web-i.
- Sistemi duhet te jete teresisht ne gjuhen shqipe
- Sistemi i ofertuar duhet të jetë COTS (Commercial off the Shelf Software).
- Cmimi i sistemit të ofruar nuk duhet të ketë varësi nga numri i përdoruesve.
- Cmimi i sistemit të ofruar nuk duhet të ketë varësi nga krijimi i ambientit test.

- Të gjithë modulet duhet të jenë të integruar me njëri tjetrin dhe të qëndrojnë mbi një platformë të përbashkët. Zgjidhjet e bazuara mbi integrimin e moduleve të ndërtuara mbi teknologji të ndryshme, apo module të gatshme me origjinë të ndryshme, nuk pranohen.
- Funksionalitetet e sistemit duhet të arrihen me parametrizime dhe konfigurime.
- Parametrizimet dhe konfigurimet, duhet të jenë të mundura të realizohen nga ndërfaqja e përdoruesit administrator të sistemit, dhe jo me ndryshime në kod apo databazë.
- Sistemi duhet të ruajë të dhënat në një bazë të dhënash relacionale, pa licence dhe pa kufizim në numër përdoruesish, volum të dhënash apo kufizime të tjera. Cdo kosto shtese për rritje të numrit të përdoruesve do të perballohet nga operatori ekonomik.
- Në çdo modul dhe çdo formë të tij, aplikacioni duhet të mundësojë export masiv të dhënash në bazë dokumentash excel ose csv.
- Sistemi nuk duhet të jetë i izoluar për të mos lejuar zhvillime apo përshtatje të mëtejshme, por duhet të ofrojë API për të shtuar module të tjera në të ardhmen.
- Moduli i gjurmëve (log) dhe sigurisë
- Sistemi duhet të ofrojë funksionalitete për monitorimin dhe auditimin e të gjithë veprimeve në sistem. Për çdo veprim duhet të ruhet data, autori (përdoruesi), rekordi i ndryshuar, fushat e ndryshuara për çdo rekord, vlerat para modifikimit dhe ajo pas modifikimit. Gjurmët e auditimit duhet të jenë të aksesueshme por të pamodifikueshme nga ndërfaqja e sistemit.
- Sistemi duhet të ofrojë të gjithë parametrat e sigurisë lidhur me autentikimin dhe kredencialet e llogarive, si vlefshmërinë dhe kompleksitetin e fjalëkalimeve të përdoruesve, skadimin e fjalëkalimeve, njoftim për afatin e skadimit etj.

Moduli i Leximit të matesve

1.1 Moduli i leximit duhet të ofrojë siguri në akses duke implementuar politika të konfigurueshme për rregullat mbi kredencialet e autentifikimit. Këtu mund të përmendim: skadencën e konfigurueshme të kredencialeve, vendosjen e detyrimeve për ndryshimin periodik të kredencialeve nga përdoruesit, vendosjen e detyrimeve ndaj përdoruesve për rritjen e fortësisë së kredencialeve duke përdorur karaktere special.

Moduli duhet të ekspozojë në mënyrë të detajuar të gjitha funksionalitetet e tij në trajtën e drejtave të përdorimit. Administratoret e sistemit duhet të mund të krijojnë role me të drejta, të percaktuara qartë dhe të detajuara.

Moduli duhet të lejojë lidhjen e kredencialeve të aksesit me adresën IP të kompjuterit të përdoruesit. Në këtë mënyrë garantohej që përdorues të tjerë nuk mund të përdorin sistemin duke përdorur kredencialet e një përdoruesi tjetër.

1.2 Ruajtja e historikut të ndryshimeve

Moduli i leximit duhet të ruajë historik të detajuar për ndryshimet që bëhen mbi entitetet në të njëjtën mënyrë si veprohet me sistemin e faturimit. Në çdo moment administratoret e sistemit duhet të mund të shikojnë të dhëna mbi vlerën e vjetër, vlerën e re, përdoruesin dhe orën e saktë kur është kryer modifikimi.

1.3 Procedurat e Back Up

Moduli i leximit duhet të garantojë procedurën të qarta për Back Up periodik të të dhënave. Të dhënat duhet të kopjohen në server të ndryshëm fizikisht nga serveri ku është instaluar sistemi.

1.4 Qëndrueshmëria e Sistemit

Seksioni III: Termat dhe kushtet e kontratës

Moduli i leximit duhet të ofrojë qëndrueshmëri të lartë duke përdorur arkitekturën të shpërndarjes së ngarkesës së përpunimit (load-balancing) për të minimizuar kohën e

mungeses se sherbimit (downtime) dhe pa ndikuar performance e sistemit te faturimit.

1.5 Optimizimi i perdorimit te bandes

Sistemi duhet te perdore teknika per optimizimin e perdorimit te bandes ne te gjitha nivelet.

1.6 Politika per shfrytezimin e kodit burimor, arkitektura e sistemit

Arkitektura e modulit duhet te jete e shtresezuar dhe kodi duhet te jete i organizuar ne klasa te riperdorshme per te thjeshtuar zgjerimet/modifikimet e ardhshme. Moduli duhet te jete i gatshem per integrim me sisteme te paleve te treta me ane te web sherbimeve. Web sherbimet duhet te garantojne aksesimin e sigurte duke perdorur kredenciale autentikimi dhe OTP (one time password).

1.7 Versionimi dhe aplikimi i modifikimeve

Kodi burimor i sistemit duhet te ruhet ne nje sistem versionimi GIT/SVN/CVS etj. Aplikimi i shtimeve apo modifikimeve te funksionaliteteve duhet te behet sipas procedurave operative te mirepercaktuara te cilat duhet te perfshijne plane per rikthimin ne gjendjen e meparshme te sistemit ne rast deshtimi.

1.8 Manuali perdorimit dhe dokumentacioni teknik

Sistemi duhet te shoqerohet me manual perdorimi ne gjuhen shqipe dhe te shpjegoje ne menyre te qarte dhe te kuptueshme te gjitha funksionalitetet e ofruara. Sistemi duhet te shoqerohet me dokumentacion teknik ne gjuhen shqipe. Ne rast te shtimit apo modifikimit te funksionaliteteve dokumentacioni perkates duhet te perditesohet.

1.9 Gjuha e sitemit.

Sistemi I administrimit dhe sistemi qe do te perdoret nga paisjet mobile duhet te jete teresisht ne gjuhen shqipe.

Karakteristika te vecanta funksionale

2.1 Karakteristika funksionale te pjeses se administrimit

Nderfaqja e administrimit eshte paneli i kontrollit per te gjithë sistemin. Ne kete nderfaqe perdoruesit menaxhojne te gjitha te dhenat te cilat akumulohen nga leximet ne terren, marin raporte operationale dhe gjithashtu reporte te ndryshme per leximet dhe reporte te tjera te nevojshme per mireorganizimin e punes. Nderfaqja e administrimit duhet te jete e thjeshte dhe intuitive per te perdorur ne menyre te tille qe te minimizoje kohen e nevojshme per ambjentimin e perdoruesve me te.

2.2 Gjate hedhjes se leximeve per abonentet sistemi duhet te mundesoje shtimin e problematikave ne nivel te palimituar nenkategorish. Ky informacion duhet te sherbeje per ndertuar reporte te detajuar per te percaktuar sakte problemet qe kane abonentet dhe veshtiresite qe kane lexuesit gjate punes se tyre.

2.3 Moduli i leximit duhet te mundesoje krijimin e ndarjes hierarkike zonale duke lejuar keshtu copezimin e zonave ne nen-zona me te menaxhueshme.

2.4 Moduli i leximit duhet te ofroje mundesi per shtimin e nyjeve teknike ne menyre hierarkike. Tipologjia e nyjeve teknike duhet te jete dinamike per te mundesuar shtimin e metejshe. Per nyjet teknike duhet te ruhet edhe statusi ne te cilin ndodhet. Status i nyjes sherben psh: per te pare impaktin ne rast te riparimeve te ndryshme apo edhe per te gjeneruar njoftime automatike ne te ardhmen.

2.5 Moduli duhet te mundesoje caktimin e zonave lexuesve. Sistemi duhet te njoftoje ne nje zone i eshte caktuar mepare nje lexuesi tjetër ne menyre te tille qe te behet perdorimi me eficence i burimeve njerezore.

2.6 Moduli duhet te mundesoje percaktimin e itinerarit te leximeve per secilin lexues ne menyre kalendarike per cdo dite. Moduli duhet te siguroje shperndarjen e lexuesve ne menyre te tille qe mos kete perpasje ndermjet tyre, nuk mund ti caktohet 2 lexuesve te njejtet abonente.

Moduli duhet te sinkronizohet me te dhenat e sistemit te aktual te faturimit. Disa nga te dhenat qe sinkronizohen me sistemin e faturimit jane:

- Te dhenat per abonentet
- Te dhenat per anomalite
- Te dhenat per zonat

2.7 Procesi I sinkronizimit duhet te jete automatik dhe real time. Moduli i leximit duhet te realizoje kalim e te dhenave te marra nga lexuesit ne menyre autmatike ne sistemin e faturimit.

2.8 Karakteristika funksionale te aplikacionit per lexuesit ne terren

Pjesa e nderveprimit midis aplikacionit per PDA dhe nderfaqes se administrimit duhet te jete parashikuar e pavarur, e bazuar ne teknologjite e web sherbimeve. Ne kete menyre ne te ardhmen aplikacioni per PDA mund te zevendesohet me aplikacion per pajisje te tjera me sisteme operimi te ndryshme.

2.9 Aplikacioni per PDA-te duhet te jete i thjeshte dhe intuitiv ne perdorim dhe te ofroje nje nderfaqe e cila punon shpejte per te lehtesuar punen e lexuesve.

3. Aplikacioni per PDA duhet te dergoje te dhena per vendodhje gjeografike te lexuesit ne momentin e marjes se leximit. Te dhenat gjeografike duhet te dergohen me nje precision sa me te larte.

3.1 Aplikacioni mbeshtetes per marjen e pozicionit gjeografik duhet te jete i optimizuar ne perdorimin e baterise.

3.2 Aplikacioni mbeshtetes per marjen e pozicionit gjeografik duhet te parashikojte situatat kur lexuesit gjenden ne zona pa mbulim nga satelitet si psh: brendesia e godinave etj.

Seksioni III: Termat dhe kushtet e kontrates

Ne kete rast aplikacioni mbeshtetes duhet te raportoje vendodhjen e fundit te sakte qe ka percaktuar nga sinjali GPS.

Aplikacioni per PDA komunikon me aplikacionin mbeshtetes te marjes se pozicionit gjeografik nepermjet tekines inter-process communication. Ne kete menyre komunikimi eshte i sigurte dhe i shpejte.

Aplikacioni per PDA duhet te ofroje mundesine e sinkronizimit te mevonshem por gjithashtu duhet te sinkronizojte te dhenat ne kohe reale ne rastet kur gjendet ne zonat me mbulim te sinjalit celular.

Aplikacioni per PDA duhet te kerkoje berjen e fotografive ne cdo rast ose bazuar mbi logjiken e percaktuar nga administratori i sistemit.

Aplikacioni per PDA duhet ti shfaqe lexuesit ne menyre te qarte itinerarin e planifikuar nga menaxheret e tyre nepermjet nderfaqes se administrimit.

Aplikacioni per PDA duhet te perdore teknikat e kompresimit te informacionit per dergimin e te dhenave ne serverin qendror duke perdorur sa me pak banden e internetit.

Aplikacioni per PDA duhet te perdore teknika te verifikimit te dergimit te sakte te dhenave ne server dhe duhet gjithashtu te perdore teknika te menaxhimit te deshtimit te lidhjes me server apo te nderprerjes se dergimit te te dhenave.

Aplikacioni per PDA duhet te perdore teknika per kriptimin e te dhenave te cilat dergon ne server duke parandaluar keshtu interceptimin e tyre nga persona keqdashes.

Nderveprimi midis pjeseve perberese

Nderfaqja e administrimit duhet te ofroje mundesi per inventarizimi e pajisjeve PDA duke

lejuar regjistrimin e informacioneve shtese per cdo pajisje si psh: status i pajisjes, personi i cili e ka ne dorezim pajisjen, version i aplikacionit te instaluar ne PDA etj.

Nderfaqja e administrimit duhet te mundesoje shfaqjen e fotografive te ngarkuara ne sistem nga aplikacioni per PDA.

Per cdo leximi te raportuar ne sistem ne nderfaqen e administrimit duhet te jepet mundesia e paraqitjes ne harte te pozicionit te lexuesit ne momentin e leximit.

Nderfaqja e administrimit duhet te ofroje raporte per nxjerrjen e variacionit te distances nga abonenti ne momentin e leximit te matesit.

Nderfaqja e administrimit duhet te mundesoje shfaqjen ne harte te itinerarit te nje lexuesi ne nje segment kohor te caktuar.

Pervec reporteve te gatshme, nderfaqja e administrimit duhet te mundesoje krijimin e reporteve ne moment nga perdoruesit e sistemit me ane te veprimeve te thjeshta 'drag and drop'.

Nderfaqja duhet te ofroje panele me informacion te shpejte ne trajten e grafikeve te llojeve te ndryshme per perdoruesit e roleve te ndryshme.

Informacioni per gjenerimin e grafikeve duhet te ekspozohet ne trajten e web sherbimeve REST ne menyre te tille qe ne ardhmen keto te dhena te perdoren per gjenerimin grafikeve ne aplikacion per smartphone per tu dhene menaxhereve te niveleve te larta informacion te shpejte ku do qe ata ndodhen.

Sherbimi mbeshtetes per sinkronizimin e te dhenave duhet te perdore teknika te menaxhimit te situatave te konkurences per te evituar rastet e bllokimit te ndersjellte (deadlocks). Aplikacioni android duhet te mund te realizoje perditesimin e vetes nepermjet internetit pa perdorur sherbimet e Google Play.

Aplikacioni duhet te ruaje log-e te aktivitetit te perdoruesit dhe duhet te mund ti dergoje keto ne server ne momentin e dergimit te kerkeses nga server.

Aplikacioni android duhet te implementoje mesazhet push te cilat mundesojne kryerjen e nje sere aktivitetesh ne PDA pa nevojen qe perdoruesi te kryeje ndonje veprim. Ky funksionalitet lehteson administrimin nga stafi qendror i IT te UK Fier dhe shmang lexuesin nga njohja me funksionalitetet teknike.

Aplikacioni android duhet te mund te ndryshoje oren dhe daten e sistemit lokal duke bere te mundur sinkronizimin e ores dhe dates me oren dhe daten e server qendror.

Afati i implementimit

Sistemi i perbere nga moduli i Leximit te matesave, duhet te implementohen ne cloud.

Implementimi I software dhe integrimi me modeulet e tjera bashke me dorzimin e PDA-ve duhet te perfundoje brenda 30 dite kalendrike nga data e nenshkrimit te kontrates.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Nr	Artikulli	Sasia
1	Zhvillim dhe Adaptim I Sistemit te Faturimit dhe Arketimit per UK Fier sh.a	1
2	Pershtatje dhe Migrim I te dhenave te Ujesjellesave Mallakaster, Patos dhe Roskovec	1
3	Zhvillim dhe implementim I Sherbimit te Pagesave (web service) Online	1
4	Program per leximin e matesave dhe integrim me Programin Flare Billing	1
5	Pajisje PDA per leximin e matesave	30

Specifikime teknike minimale te nevojshme per PDA

1. Modeli paisjes: PDA
2. Ekran: ≥ 4 inch me rezolucin HD
3. Mdrojtja IP68
4. Duron rrezimin nga lartei te pakten 1.7m
5. Ekran tuch qe pranon Sensor Drite, Graviteti, Arersi, Sensor per fushen majetike dhe Giroskopi
6. Scanner: Scaner professional per barkod dhe te funksionoje nga te pakten 1 meter largesi
7. Tastjer Alfanumerike e lehte e aksesushme dhe me butona anesore per perdorim te shpejte te skanimit
8. Card Solot: Nano SIM + SIM + Micro SD
9. Komunikim 4G/3G
10. Memory: 2 GB Ram\32 GB Rom
11. WiFi: 2.3Ghz/5Ghz/IEEE802.11
12. GPS: AGPS/GPS/Galileo
13. Blututh: 5.0
14. NFC: Po
15. Mikrofon: Po

16. Porte: Type C
17. Camera: ≥ 13 MP Mbrapa/ ≥ 5 MP Para
18. Pesha: < 245 gr
19. Permasat: Gjeresi ≤ 65 mm dhe Trashesi ≤ 15 mm (permasa qe bejne te mundur perdorimin sa me te lehte ne pellemen e dores)
20. Bateri e zevendesueshme lehtesisht nga perdoruesi (Removable)
21. Bateria te jete te pakten 3.8V/5000mAh
22. Paisja te jete rezistente nga uji deri ne 1.2 metra thellesi
23. Paisja te punoje ne temperature $\leq -20^{\circ}\text{C}$ deri ne temperature $\leq 55^{\circ}\text{C}$
24. Memorja (Storage) e pajisjes te punoje dhe te ruaje informacionin ne temperature $\leq -40^{\circ}\text{C}$ deri ne temperature $\geq 70^{\circ}\text{C}$
25. Te kete karikuesin te perfshire dhe te jete origjinal nga prodhuesi

Arsyetimi i zgjedhjes për ofrimin e këtij shërbimi online/dixhital dhe jo përmes prokurimit të një serveri fizik, janë:

- ❖ Kosto më e ulët nga blerja e serverit fizik
- ❖ Ofron siguri më të lartë nga sulmet kibernetike, duke garantuar ruajtjen e të dhënave
- ❖ Lehtësi në përdorim

Shënim: *Provat para dhe pas riparimit të elektromotorëve, do të bëhen në praninë e përfaqesuesve me autorizim të Sh.a Ujesjelles Kanalizime Fier, me të cilët do të mbahet një procesverbal për defektin e konstatuar para riparimit dhe një procesverbal për defektin e riparuar pas riparimit. Pas riparimit dhe marrjes në dorëzim nga Sh.a.U.K.Fier, pjeset e vjetra të dëmtuara do të dorëzohen sipas preventivit në kompaninë tonë me një procesverbal të vecantë. Dorëzimi i mallit nga ofcina riparuese përkatëse do të bëhet përmes Akt-testimit dhe Akt-kolaudit sipas standarteve në fuqi për secilën paisje. Ofertuesi duhet të lëshojë fletë-garanci për 1 vit për cdo elektromotor të riparuar. Periudha e garancisë do të fillojë nga momenti i vënies në punë të elektromotorëve të riparuar në Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Fier.*

NJËSIA E PROKURIMIT
